



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
DREJTORIA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Nr. 5241/14 Prot

Tiranë, më 13/02/2023

Lënda: Njoftim për përfundimin e procedurës pa fitues

DREJTORISË SË MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN

KËTU

**DREJTORISË RAJONALE TË AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE
AFTËSIVE TIRANË**

Në zbatim të Ligjit nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjit nr.15/2019 “Për nxitjen e punësimit”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.554 datë 31.07.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive”, Urdhërit të Kryeministrit nr.172, datë 24.12.2019 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.15, datë 29.04.2022 “Për mënyrën e emërimit dhe të lirimt nga detyra të punonjësve të Drejtorive Rajonale të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive që trajtohen me Kodin e Punës”, shkresës me nr.7864 prot, datë 09.12.2022 “Kërkesë për shpallje vendi të lirë pune”, të Drejtorisë Rajonale të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, Tiranë, protokolluar në AKPA me nr.5241 prot, datë 09.12.2022 “Njoftim për vend të lirë pune” të AKPA- s dhe shkresës me nr.5241/3 prot., datë 02.02.2023 “Njoftim për vend të lirë pune” të AKPA- s për procedurën e shpalljes së vendit të lirë të punës për pozicionin: Specialist në Sektorin e Menaxhimit të Ofrimit të Shërbimeve të Punësimit, Zona 1, për zëvendësim leje barrëlindje, në Drejtorinë Rajonale të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, Tiranë, asnjë kandidat nuk ka paraqitur dokumentacion në fazën e parë pranë protokollit të Drejtorisë Qendrore të AKPA-s.

Sa më sipër, njoftojmë përfundimin e procedurës pa fitues, për pozicionin e punës: Specialist në Sektorin e Menaxhimit të Ofrimit të Shërbimeve të Punësimit, Zona 1, për zëvendësim leje barrëlindje, në Drejtorinë Rajonale të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, Tiranë.

DREJTORI PËRGJITHSHËM

Klevis HYSA